



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3559/12 Prot.

Tiranë, më 21/12 2023

V E N D I M

Nr. 81 datë 21.12 2023

**“PËR
MIRATIMIN E SHPENZIMEVE PËR PLANIN PËR MODULET “SKI” PËR
STUDENTËT E FSHL DHE PROGRAMIN OUTDOOR “SPORTE DIMËRORE-
SKI” PËR STUDENTËT E FVFR DHE MIRATIMIN E REGJISTRIT TË
PARASHIKIMIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2024
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e RSH", të ligjit 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të vendimit të Bordit të Administrimit nr. 56 datë 07.08.2023 "Mbi Miratimin e Propozimit të Programit Buxhetor Afatmesëm për vitin 2024-2026, për Universitetin e Sporteve të Tiranës , të shkresës nr. 3123/1, datë 17.11.2023, nr 3123/4 datë 5.12.2023 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, të shkresës nr 3425, datë 11.12.2023, nr 3443/1 datë 13.12.2023 të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Vendimit të Senatit Akademik me Nr. 143 datë 19.12.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 21.12.2023,

V E N D O S I :

1. Të miratojë të gjitha shpenzimet për planin mësimor të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit përkatësisht për modulet "Ski" për studentët e FSHL dhe programin Outdoor "Sporte Dimërore-Ski" për studentët e FVFR.
2. Të miratojë propozimin e Regjistrisë të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2024, në Universitetin e Sporteve të Tiranës sipas tabelës bashkëngjitur.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARTUR COBANI



Autoriteti Kontraktor: Universiteti i Sporteve të Tiranës

Regjistri i Parashikimeve të Prokurimeve Publike viti 2024

602.91	2024	I ri	Modul I skive per studentet e FSHL	Kontratë	Shërbim	5,038,677	Buxheti i Shtetit	5,651,864	Tender i hapur i thjeshtuar	55100000-4 60140000-1 92600000-7 55521200-0	Gjate vitit 2023-2024	UST
602.91	2024	I ri	Ofrimi I sherbimim it te programit outdoor "Sporte dimerore" per studentete e FVFR	Kontratë	Shërbim	5,717,565	Buxheti i Shtetit	6,414,786	Tender i hapur i thjeshtuar	55100000-4 60140000-1 92600000-7 55521200-0	Gjate vitit 2023-2024	UST